



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.196/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit KRM Ekoregjioni sh.a. me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zahir Smaili avokat në Prizren, ndaj debitorit T.G. B.I.-NT “Atmaxha Trans” me seli në Prizren të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Asman Hoxha avokat në Prizren, me bazë juridike, përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.826/23 datës 29.11.2023, me datën 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit KRM Ekoregjioni sh.a. me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.826/23 i datës 29.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhoma e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP nr.826/23 datës 29.11.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit T.G. B.I.-NT “Atmaxha Trans” me seli në Prizren, ka anuluar urdhrin përmbareme P.nr.131/2022 datë 01.04.2022 i lejuar nga Përmbaremi Privat Enis Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, cenimit të dispozitave të procedurës përmbareme dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, ta prish aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.826/23 i datës 29.11.2023, dhe prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KRM Ekoregjioni sh.a. me seli në Prizren, me datën 01.04.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit T.G. B.I.-NT “Atmaxha Trans” me seli në Prizren, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.PZ1023104 datës 28.02.2021, në vlerë prej 441.00€

Përmbartuesi Privat Enis Hoxha nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.131/2022 dt.01.04.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura ti paguaj shumën prej 441.00€, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit, debitori, ka paraqitur prapësim, me pretendimin se debitori është pagues i rregullt i të gjitha obligimeve të kreditorit, e ky fakt vërtetohet nga vërtetimi i datës 14.02.2022 nr.klientit 9993 si dhe nga vërtetimi nr.protok.238106/2022 dt.07.04.2022. Këto vërtetime janë lëshuar nga Komuna e Prizrenit, me të cilat sqarohet se debitori është pagues i rregullt i shërbimeve komunale, borxhi i akumuluar deri me datën 01.04.2021 është përfshirë në parashkrim mbi bazën e nenit 360 të LMD-së, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet prapësimi ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet jashtë fuqie.

Kreditori në përgjigje në padi ndaj prapësimit ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, se faturat dhe kartela e konsumatorit i janë dorëzuar përmbartuesit privat në origjinal, në përputhje me nenin 29.3 të LPP-së. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim pasi që edhe vet përfaqësuesi i debitorit e ka pohuar se debitori ka bërë pagesa të rregullta, andaj parashkrimi është ndërprerë, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim të refuzohet dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe shkresave tjera në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.826/23 datës 29.11.2023, me të cilin e ka Pranuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar Urdhrin për përmbartim P.nr.131/2022 i datës 01.04.2022 i lejuar nga përmbartuesi privat Enis Hoxha. Në arsyetim të aktvendimit gjykata thekson se fatura nr.PZ21023104 datës 28.02.2021 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 par.3 i LPP-së, pasi që në faturën e lartcekur, tek pranuesi i saj nuk identifikohet debitori qoftë me vënien e nënshkrimit apo vulosjen e kësaj fature. Në anën tjetër kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë tjetër se fatura e lartcekur i është dorëzuar debitorit në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme në mënyrë që ky i fundit të njoftohet me detyrimin që rrjedh nga kjo faturë. Kreditori ka bashkangjitur propozimit për përmbartim edhe një kartelë të konsumatorit dt.24.02.2022 në kopje, por që në propozimin për përmbartim rezultojnë

se kreditori ka specifikuar si dokument faturën nr.PZ21023104 dt.28.02.2021 kjo në përputhje me nenin 38 par.1 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbaremi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së, pra janë në mospajtim me dispozitat ligjore.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve, rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Po ashtu Dhomat e shkallës së dytë vlerëson edhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*.

Në rastin konkret fatura e lartcekur, nuk plotëson kushtet ligjore për tu përmbareuar sepse e njëjta nuk është e vulosur nga debitori e as e nënshkruar nga ana e tij, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se debitori e ka pranuar këtë faturë, çka do të thotë se e njëjta është lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit. andaj kjo gjykatë vlerëson se pretendimi i kreditorit se Dhoma e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike nuk qëndron, pasi në lidhje me këtë nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në argumentimin e pretendimit të tij ashtu që kjo gjykatë, aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoj, kurse ankesën e kreditorit e refuzoi si të pabazuar.

Përndryshe në procedurën përmbaremore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbareues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbaremin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.196/24 me datë 22.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha